



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!


Në këtë buletin do të gjeni:



Rritja e Kapacitetit Institucional për Menaxhimin e Kimikateve



Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, 2026



Java Ndërkombëtare e Parandalimit të Helmimit nga Plumbi



Raporti i Gjendjes në Mjedis 2024



Bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Kimikateve



Raportimi për ajrin urban të Shqipërisë



Takimi Rajonal mbi Emërtimin e Mundshëm të Detit Mesdhe si një Zonë Kontrolli të Emetimeve të Oksideve të Azotit.



Shqipëria në Raportin “Mjedisi i Evropës 2025”



Takimi i palëve mbi protokollin e PRTR dhe Konventën Aarhus



Integrimi i Shqipërisë në punën e Agjencisë Europiane të Mjedisit



Zhvillimi i kapaciteteve për një monitorim kimik në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit



Evidentimi i kapaciteteve të institucioneve kërkimore shkencore për monitorimin e pasurive ujore në Shqipëri



Fushata ndërgjegjësuese për pastrimin e mjedisit



Sistemi i Integruar Mjedisor



Bashkëpunimi me EU4Green



Biznese të çliruara nga detyrimet e lejeve mjedisore



Aktivitete në lidhje me Lejet Mjedisore, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Inspektimet

Rritja e kapacitetit institucional për menaxhimin e kimikateve

Në datat 8 -11 Shtator u zhvillua takimi në ambientet e Tirana International Hotel, me mbështetjen e TAIEX dhe ekspertëve teknikë nga vende të ndryshme si Slloveni, Kroaci etj.

Ky takim synoi rritjen e njohurive dhe kapacitetin institucional të ekspertëve të sektorit publik të përfshirë në rregullimin dhe menaxhimin e kimikateve.

Gjithashtu u përqendrua në kornizat ligjore, praktikat e zbatimit dhe zhvillimin institucional të lidhur me rregulloret e mëposhtme të BE-së për kimikatet si Rregullorja (BE) Nr. 1907/2006 (REACH), Rregullorja (BE) Nr. 1272/2008 (CLP), Rregullorja (BE) Nr. 528/2012 (BPR), Rregullorja (BE) Nr. 649/2012 PIC, Rregullorja (BE) Nr. 2019/1021 (POP), Rregullorja (BE) Nr. 852/2017 Rregullorja e Mërkurit.



Takimi u bazua në detyrimet dhe sfidat e zbatimit që lidhen me REACH, CLP, BPR, POPs, PIC dhe Rregulloren e Mërkurit. Po ashtu, u shqyrtuan rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve kombëtare, në zbatimin dhe përafrimin me rregulloret e kimikateve të BE- dhe praktikat më të mira në zhvillimin institucional dhe bashkëpunimin ndërsektorial për zbatimin sa më efektiv të rregulloreve.



Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit, 2026



Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka përgatitur Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2026.

Ky program hartohet bazuar në VKM-në Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”.

Monitorimi i mjedisit siguron rezultate për vlerësimin e gjendjes në mjedis si dhe të ndikimit të aktivitetit njerëzor që mund të paraqesin rrezik dhe efekte të dëmshme për mjedisin natyror.

Monitorimi i mjedisit është një sistem, i cili nëpërmjet paraqitjes së treguesve mjedisorë, vlerëson kushtet mjedisore, ndotjen nga aktivitetet e subjekteve operuese si edhe studion tendencat mjedisore. Monitorimi mjedisor, mbështetet në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e tyre, sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për raportimin tek politikëbërësit kombëtarë.

Një pjesë integrale e monitorimit mjedisor është zhvillimi i një programi të monitorimit. Qëllimi kryesor i programit është të ofrojë informacion mbi situatën mjedisore dhe për të ndihmuar në marrjen e vendimeve për përmirësim.

Programi i monitorimit mjedisor përfshin informacione në lidhje me treguesit mjedisor që duhet të monitorohen (ajri, zhurmat, toka, ujërat sipërfaqësor, bregdetar, nëntokësor, sipërfaqet pyjore, biodiversitetin etj), vendi i kampionimit, parametrat përkatës, frekuenca e monitorimit, paraqitja e të dhënave si dhe institucionet monitoruese.

Ky program është një komponent i rëndësishëm që mund të përdoret për forcimin e institucioneve në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për monitorimin mjedisor.


Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2026, është i publikuar në faqen zyrtare të AKM (www.akm.gov.al).



Java Ndërkombëtare e Parandalimit të Helmimit nga Plumbi



Në datat 19-25 Tetor 2025, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i'u bashkua Institutit të Shëndetit Publik dhe Universitetit të Mjekësisë Tiranë në Javën Ndërkombëtare të Parandalimit të Helmimit nga Plumbi.



Gjatë takimeve u theksua nevoja për veprim të menjëhershëm për të parandaluar ekspozimin e fëmijëve dhe për të mbrojtur shëndetin e tyre dhe mjedisin nga plumbi.



Raporti i Gjendjes në Mjedis 2024



Raporti i Gjendjes në Mjedis 2024, i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, paraqet vlerësimin e situatës mjedisore në vendin tonë bazuar mbi informacione dhe të dhëna për komponentët mjedisor.

Ky raport përmban kapituj për cilësinë e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, ajri dhe ndryshimet klimatike, zhurmat, mjedisi bregdetar, tokat, menaxhimi i mbetjeve, pyjet, zonat e mbrojtura, mjedisi dhe sektorët ekonomik.

Nëpërmjet këtij raporti synojmë lehtësimin e marrjes së informacionit mjedisor për publikun si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu ka si qëllim njohjen e gjendjes në mjedis për politikëbërësit dhe marrja në konsideratë e masave/rekomandimeve për parandalimin e ndotjes apo përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Në këtë raport janë trajtuar çështje të reja si;

- ✓ Studim i monitorimit të rrjedhjeve të plastikës në sistemet ujore.
- ✓ Vlerësim social- ekonomik.
- ✓ Ndërlidhjet e mjedisit me sektorët e tjerë ekonomik.

Mesazhet kryesore të RGJM 2024

1.Përfshirja e rekomandimeve dhe masave përmirësuese të gjetura nga vlerësimi i gjendjes së mjedisit në politikat mjedisore.

2.Ofrimi i një pozicioni të politikës kombëtare për mjedisin për të trajtuar ndërveprimet, sinergjitë dhe shkëmbimet në të gjithë fushat e politikave mjedisore dhe për t'u ndërvepruar me fusha të tjera të politikave sektoriale.


3.Shtytja e zbatimit të politikave për të arritur përfitimet dhe objektivat e përcaktuara.

4.Transformimi i sektorëve të energjisë, transportit, bujqësisë dhe industrisë është e domosdoshme për arritjen e një të ardhmeje të qëndrueshme.

5.Investimi në infrastrukturën e ujit, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, energjisë, transportit, bujqësisë dhe menaxhimit të mbetjeve është thelbësore për të mbrojtur mjedisin në vazhdueshmëri.

6. Mbrojtja e mjedisit është çelësi për mbrojtjen e shëndetit dhe ne duhet të veprojmë për të reduktuar rreziqet nga ekspozimet mjedisore.

Gjithashtu është publikuar edhe një përmbledhje e shkurtër e RGJM 2024, "Gjendja Mjedisore dhe Veprimet për Përmirësim" në shqip dhe anglisht.



Dy dokumentet e sipërmendura janë të publikuara dhe të disponueshme për publikun e gjerë në faqen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit www.akm.gov.al.

Bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Kimikateve

Gjatë datave 10-11 Nëntor në Mal të Zi u zhvillua takimi i TAIEX mbi legjislacionin e BE-së për kimikatet, mbështetja e përfituesve të IPA-s në rrugën e anëtarësimit në BE. Ky takim u organizua në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Kimikateve (ECHA) ku nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit morën pjesë dy përfaqësues.



Objektivi kryesor i këtij takimi ishte t'u ofrojë përfituesve të IPA-s kuptimin dhe njohuritë e nevojshme për të përafuar legjislacionin e tyre kombëtar me legjislacionin e kimikateve të BE-së dhe për të rritur gadishmërinë e tyre për të marrë përsipër rolin e tyre në rrugën drejt anëtarësimit në BE në fushën e legjislacionit të BE-së për menaxhimin e kimikateve.



Gjatë dy ditëve të takimit u diskutuan të gjitha direktivat e BE-së REACH, CLP, PIC, POPs dhe Produkteve Biocide.

Raportimi për ajrin urban i Shqipërisë

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për raportimet e treguesve mjedisor në Agjencinë Europiane të Mjedisit (AEM). Në këtë kuadër janë kryer takime në lidhje me raportimin për ajrin urban.

Në datat 1-2 Tetor 2025, në ambientet e Agjencisë Europiane të Mjedisit, Kopenhagen, Danimarkë u mbajt takimi Eionet, Grupi i Ajrit. Në këtë takim morën pjesë ekspertë nga vendet anëtare dhe vendet bashkëpunuese të BE.



Në takim u diskutuan disa tematika lidhur me:

- ✦ Tranzicioni nga Reportnet 2 në Reportnet 3 për raportimin e të dhënave të cilësisë së ajrit
- ✦ Rishikimi i direktivës së re të cilësisë së ajrit (direktiva e cilësisë së ajrit 2024/ 2881) në lidhje me indikatorët, pikat e mostrimit, standartet. etj
- ✦ Mjetet dhe produktet e AEM për ajrin urban dhe emisionet në ajër si dhe planet për 2026

Gjatë sesionit "Bring it together", nga vendet pjesëmarrëse u prezantuan ide të reja, aktivitete, studime shkencore në lidhje me cilësinë e ajrit. Takimi u mbyll me një dialog për tematikat e cilësisë së ajrit

Gjithashtu me ekspertë të Agjencisë Europiane për raportimet, u diskutua në lidhje me raportimin e të dhënave në kohë reale (UP-TO-DATA) dhe si rezultat i këtij diskutimi dhe përpjekjeve të ekspertëve të AEM dhe AKM, Shqipëria për herë të parë ka filluar transmetimin e të dhënave **në kohë reale** të cilësisë së ajrit në bazën e të dhënave në Agjencinë Europiane të Mjedisit.

Takimi i 16 i Zbatimit të Dispozitave për Raportim (Vendimi 2011/850 i Bashkimit Europian) u organizua nga Agjencia Europiane e Mjedisit në datë 13-14 Nëntor 2025 në Varshavë të Polonisë për vendet e BE dhe online për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Takimi u fokusua në disa çështje:

- 1- Përditësime lidhur me direktivën e rishikuar të cilësisë së ajrit të mjedisit (direktiva e cilësisë së ajrit 2024/ 2881).
- 2- Kërkesat e raportimit të të dhënave të cilësisë së ajrit sipas direktivës së rishikuar dhe Reportnet 3. Skema e raportimit për Reportnet 3, zgjidhjet dhe udhëzuesi i raportimit. Rrjeti koordinativ, raportimi i ndotësve sipas direktivës së rishikuar (UFP, PNSD, BC) dhe paraqitja në RAVEN 3.
- 3- Përmbledhje e raportimit të të dhënave me afat 30 Shtator 2025 për dataflow B-G, rishikim i çështjeve lidhur me dataflow E1a dhe kontrolli i sigurimit të cilësisë.
- 4- Raporti i cilësisë së ajrit të Europës (draft raporti), statusi i të dhënave në kohë reale (UTD Data) dhe raportimi i të dhënave H-K.

Takimi Rajonal mbi Emërtimin e Mundshëm të Detit Mesdhe si një Zonë Kontrolli të Emetimeve të Oksideve të Azotit.

Qendra Rajonale e Reagimit ndaj Emergjencave të Ndotjes Detare për Detin Mesdhe (REMPEC), në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin organizoi Takimin Rajonal të Ekspertëve mbi Emërtimin e Mundshëm të Detit Mesdhe, në tërësi, si një Zonë Kontrolli të Emetimeve të Oksideve të Azotit (Med NOX ECA).

Takimi u zhvillua në Maltë, në datat 18-19 Nëntor 2025, ku nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesëmarrës një përfaqësues nga Sektori i Menaxhimit të Kimikateve.



Përtej rritjes së ndërgjegjësimit mbi zbatimin efektiv të Shtojcës VI të MARPOL-it dhe udhëzimeve përkatëse në rajonin e Mesdheut, përmes një sërë prezantimesh nga Konsulentët e REMPEC-it, si dhe përfaqësues të IMO-së, takimi shqyrtoi dhe diskutoi draftin e Studimit Përfundimtar Teknik dhe të Fizibilitetit për të vlerësuar studimet përkatëse ekzistuese dhe në vazhdim. Po ashtu edhe për të shqyrtuar përcaktimin e mundshëm të Detit Mesdhe, si një Zonë Kontrolli të Emetimeve për Oksidet e Azotit, në përputhje me Shtojcën VI të MARPOL.



Gjatë gjithë seancës konsultative, ekspertët kombëtarë vlerësuan përfitimet e pritura mjedisore nga reduktimi i emetimeve të NO_x, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë së ajrit, përfitimet në shëndetin publik dhe mbështetjen e angazhimeve kombëtare dhe rajonale për klimën dhe reduktimin e ndotjes. Takimi gjithashtu shqyrtoi fizibilitetin teknik, datat e mundshme të hyrjes në fuqi, mekanizmat e pajtueshmërisë dhe ndikimet e mundshme ekonomike që lidhen me përcaktimin e mundshëm të një ECA-je Mesdhetare të NO_x, në përputhje me Aneksin VI të MARPOL-it.

Shqipëria në Raportin “Mjedisi i Evropës 2025”




Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesëmarrëse në prezantimin e raportit *Mjedisi i Evropës 2025*, një publikim i përgatitur nga AEM çdo pesë vjet, i mbështetur në të dhëna nga 38 vende, përfshirë edhe partnerët e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë raport është përfshirë edhe profili i Shqipërisë, i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me ekspertët e Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM).

Profili i Shqipërisë ofron vlerësime mjedisore në nivel kombëtar, trendet mjedisore kryesore në mjedis dhe klimë, zhvillimet social-ekonomike dhe ndryshimet në lidhje me sistemet për energjinë, lëvizshmërinë dhe ushqimin.

Prezantimi u mbajt në Podgoricë 25 Nëntor 2025 për gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor duke sjellë përfaqësues nga Shqipëria, Kosova, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.



Në sesionin e prezantimit të raportit u theksuan mesazhet kryesore, roli i rajonit në kontributin e të dhënave dhe rëndësia e harmonizimit të raportimeve me standardet e BE-së. Në vijim të ditës u zhvilluan diskutime mbi kontributet e vendeve të rajonit, sfidat e përbashkëta mjedisore, përparësitë strategjike dhe rolin e bashkëpunimit shumëvjeçar mes AEM dhe Ballkanit Perëndimor.

Ky raport është një mjet komunikimi i fuqishëm mes institucioneve që prodhojnë analiza, vlerësime, njohuri dhe dije shkencore mbi gjendjet dhe situatën e mjedisit me politikëbërësit evropianë dhe kombëtarë nga njëra anë dhe publikut nga ana tjetër.

Takimi i palëve mbi protokollin e PRTR dhe Konventën Aarhus

Agjencia Kombëtare e Mjedisit edhe këtë vit ishte pjesë e Sesionit të pestë të Takimit të Palëve në Protokollin mbi Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR) i cili u zhvillua në Gjenevë më 21 Nëntor 2025. Ai u mbajt paralelisht me sesionin e tetë të Takimit të Palëve në Konventën mbi të Drejtën e Publikut për Informacion, Pjesëmarrje në Vendim Marrje dhe të Drejtën për t'iu Drejtuar Gjykatës, për Çështje që Lidhen me Mjedisin (Konventa e Aarhusit) (17-19 nëntor 2025), ku u përfaqësua nga Ministria e Mjedisit.

Të dy sesionet përfshinë një Segment të përbashkët të Nivelit të Lartë më 20 Nëntor 2025, ku delegacionet u përqendruan në rolin e Konventës së Aarhusit dhe Protokollit të saj në avancimin e të drejtave publike për të trajtuar krizën e trefishtë planetare të ndryshimeve klimatike, humbjes së biodiversitetit dhe ndotjes. Gjatë këtij segmenti, vendi ynë paraqiti një video mesazh nga Z. Sofjan Jaupaj, Ministri i Mjedisit, ku u theksua se fokusi kryesor është në ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe ndotjen si dhe në raportimin e të dhënave mjedisore nëpërmjet portalit qeveritar e-albania.



Palët anëtare në të dy traktatet dhe një gamë e gjerë palësh të interesuara miratuan Deklaratën e Gjenevës mbi avancimin e të drejtave publike për të trajtuar krizën e trefishtë planetare përballë tensioneve gjeopolitike.



Sesioni i pestë ofroi një platformë për Palët, Nënshkruesit, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara për të diskutuar arritjet dhe sfidat në promovimin e një game të gjerë temash relevante për Protokollin mbi PRTR-të.

Sesioni rezultoi në një sërë rezultatesh, duke përcaktuar prioritetet për punën e ardhshme deri në vitin 2029 për të çuar përpara zbatimin dhe pajtueshmërinë me Protokollin. Midis tyre, një vendim për modernizimin e mëtejshëm të regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, promovimin dhe sinergjinë e tyre globale, mbi një program të ri pune dhe mbi rregullimet financiare.

Takimet konfirmuan rëndësinë e bashkëpunimit shumëpalësh për demokracinë mjedisore dhe sollën rezultate të rëndësishme, përfshirë: pranimin e Uzbekistanit dhe Guinea-Bissau si Palë të reja të Konventës; hyrjen në fuqi të amendamentit për OMGJ-të (Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht); miratimin e 21 vendimeve për pajtueshmëri; vendim mbi promovimin e mbrojtjes efektive të mbrojtësve të mjedisit; modernizimin e sistemeve PRTR dhe miratimin e Deklaratës së Gjenevës për adresimin e krizës planetare trefishtë.

Gjithashtu, u miratuan programet e punës dhe marrëveshjet financiare për periudhën 2026–2029 dhe u zgjodhën anëtarët e organeve drejtuese përkatëse, ku Shqipëria është përsëri pjesë e byrosë për katër vitet e ardhshme.

Integrimi i Shqipërisë në punën e Agjencisë Europiane të Mjedisit

Në datë 26.11.2025 vijoi takimi teknik “Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në punën e AEM dhe Eionet”, ku u prezantua faza e re e bashkëpunimit, pritshmëritë për raportimin e ardhshëm dhe nismat rajonale, përfshirë asistencën teknike për ngritjen e sistemeve të raportimit në Bosnje e Hercegovinë dhe Mal i Zi. Sesionet tematike u zhvilluan për Ajrin, Ujin dhe Tokën ku vendi ynë u përfaqësua nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Universiteti Bujqësor, të fokusuar në përmirësimin e proceseve të raportimit dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve teknike dhe monitoruese.



Në përfundim, pjesëmarrja e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në këtë aktivitet rezultoi e dobishme për forcimin e bashkëpunimit rajonal, rritjen e koordinimit me AEM dhe qartësimin e detyrimeve të raportimit për periudhën e ardhshme. Rezultatet e takimit nënvizojnë nevojën për rritjen e rrjetit monitorues, rritjen e cilësisë së të dhënave mjedisore dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në vend.



Zhvillimi i kapaciteteve për një monitorim kimik në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të laboratorëve nga EU4Rivers u organizua trajnim në datë 10.12.2025, Hotel Tirana, ku morën pjesë përfaqësues të laboratorit të AKM si dhe nga laboratorët e institucioneve të tjera.

Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të stafit të laboratorëve në lidhje me plotësimin e kërkesave të Direktivës Kuadër të Ujit.

Znj.Roza Allbashi dhe Z. Stefan Hann (BOKU) prezantuan detyrimet që rrjedhin nga Direktiva Kuadër e Ujit për laboratorët që monitorojnë cilësinë e ujërave. Hapat që duhen ndjekur për verifikimin/vlefshmërinë e metodave analitike që përdoren për përcaktimin e parametrave.

Më pas trajnimi vijoi me procesin e akreditimit në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për aktivitetin e laboratorit si dhe zbatimin e standartit ISO 17025:2017 për “Kërkesat e kompetencës të laboratorëve testues dhe kalibrues”. Dokumentacioni që kërkohet të paraqitet për procesin e akreditimit fillestar, zgjerimit të fushës së akreditimit dhe riakreditimit.



Gjithashtu u njohëm me menaxhimin e cilësisë dhe kërkesat e dokumentacionit për laboratorët analitik në lidhje me trajnimet, kompetencat, kalibrimi i pajisjeve, përgjegjësitë për analizimin, dokumentacioni për dosjen e personelit. Në fund u organizua një punë në grup për zhvillimin e konceptit të verifikimit të metodës në një laborator analitik bazuar mbi një metodë ISO.



Evidentimi i kapaciteteve të institucioneve kërkimore shkencore për monitorimin e pasurive ujore në Shqipëri



Në datë 12 Dhjetor, u zhvillua tryeza e rumbullakët e organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Njësia Kërkimore Shkencore “Pasuritë Ujore”, me temë: “Evidentimi i kapaciteteve të institucioneve kërkimore shkencore në lidhje me monitorimin e pasurive ujore në Shqipëri”

Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Gjatë takimit u mbajtën fjalët përshëndetëse dhe më pas vijuan me prezantimet tematike mbi:

- Kapacitetet kërkimore shkencore në lidhje me monitorimin e ujërave,
- Roli i agjencive shtetërore në monitorimin e ujërave si dhe nevojat për mbështetje teknike.
- Përvoja e përfshirjes së universiteteve në monitorimin e ujërave.

Gjithashtu pati diskutime për plotësimet e mundshme mbi kapacitetet teknike dhe metodologjike nga institucionet shkencore, adresimi i mungesës së standarteve të harmonizuara me Direktivën Kuadër të Ujit, për monitorimin dhe bashkëpunimin shkencë-vendimmarrje, përfshirja e laboratorëve universitarë në Programin Kombëtar të Monitorimit për ujërat si dhe rrugët për përfshirjen e profesionistëve të rinj në problematikën aktuale.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte evidentimi i kapaciteteve shkencore, dhe mundësia e përfshirjes së tyre në programet kombëtare të monitorimit dhe vlerësimit të pasurive ujore, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit u informuan se Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka publikuar në faqen zyrtare web, Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2026 si dhe njoftimin ku ftohen palët e interesuara të dërgojnë projekt propozime për parametrat që nuk mund të monitorohen nga Laboratori i AKM-së.


Gjithashtu i'u bë me dije të pranishmeve procedura e punës së AKM-së dhe disponibiliteti për të bashkëpunuar me institucionet shkencore dhe të gjithë aktorët e përfshirë në monitorimin e ujërave.



Fushata ndërgjegjëse për pastrimin e mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM-Tiranë/Durrës/Dibër, ARM-Fier/Vlorë-Gjirokastrë, ARM-Lezhë/Shkodër/Kukës dhe ARM-Elbasan/Korçë/Berat) përgjatë muajit dhjetor kanë zhvilluar aksione për pastrimin e ambienteve në zonat më të frekuentuara dhe më të ndjeshme, me synim përmirësimin e pastërtisë së mjedisit, reduktimin e ndotjes si dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Janë kryer fushata pastrimi në Kashar, Shijak, zonën e plazhit Seman, segmentin rrugor nga Ura e Goricës drejt fshatit Drobonik, Kalaja e Beratit, Vain-Lezhë dhe në grykëderdhjen e lumit Drin.



Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të nismës për pastrimin e mjedisit dhe angazhimit për mirëmbajtjen dhe menaxhimin më të mirë të ambienteve të përbashkëta, mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e bukurisë së zonave tona.




Sistemi i Integruar Mjedisor

Me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale në kohë dhe me cilësi më të mirë, në bashkëpunim me AKSHI-n, po punohet për “Përmirësimin e Sistemit të Integruar Mjedisor- SIM, për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”, ku pjesë e sistemit do të jetë edhe procedura e monitorimeve të LM dhe VNM. Synohet që nëpërmjet sistemit, subjektet raportues të hedhin raportet e vetëmonitorimeve, gjë që çon në eliminimin e procesit manual të hapjes, kopjimit, regjistrimit të CD.

Ky sistem sjell këto të mira:

- Koha e harxhuar për këtë proces, automatikisht shkon në kohë cilësore për shqyrtimin e raporteve;
- Eleminohet ngarkesa e shkresave fizike në protokoll;
- “Share” për nga pikëpamja e IT, nuk ka garanci për ruajtjen e informacionit të hedhur, ku vlen të përmendet rasti i dëmtimit të tabelës së të dhënave në EXCEL;
- Automatikisht gjenerohen të dhëna nga sistemi, lidhur me monitorimet;
- Përfshirja e strukturave të varësisë pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit, me qëllim ndarjen e ngarkesës, sipas subjekteve në secilin rajon, si dhe në koordinimin e mirë të të dhënave në kohë reale, midis institucionit qendror AKM dhe atij rajonal ARM-së.

Nëpërmjet SIM, sigurohet integrimi dhe shkëmbimi i të dhënave me sisteme të tjera qeveritare dhe operatorët privatë, duke siguruar një platformë të unifikuar dhe të koordinuar për menaxhimin e informacionit mjedisor me të dhëna si: akte të miratuara (leje/VNM/liçensa), raportet e vetëmonitorimeve, mbetjet që gjenerohen në Shqipëri nga të gjitha llojet e rrymave si dhe nga operatorë privat dhe publik, regjistri i shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve, regjistri i kimikateve, etj...



SIM ndërvepron me:

- e-lejet në mënyrë që Sektori i Monitorimeve të ketë akses të shikojë kur një VNM është miratuar për të verifikuar më pas nëse ky operator ka raportuar apo jo raportin e vetëmonitorimit 6-mujor.
- Me regjistrin e lejeve dhe liçensave të QKB për publikimin e lejeve.
- Me e-inspektimin të IQ, për të dhënat e inspektorëve në terren.
- Me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për të dhënat e shtetasve shqiptarë
- Me Regjistrin elektronik të adresave në Republikën e Shqipërisë


Për këtë proces, në kuadër të funksionimit të SIM, gjatë vitit 2025:

- Është lidhur Kontrata Nr. 119, datë 24.12.2024, me titull “Përmirësimi i Sistemit të Integruar Mjedisor”, ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe operatorit ekonomik Fastech sh.p.k., me përfitues Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- Lidhur me zbatimin e kontratës, jemi në fazën e testimit dhe trajnimit të stafit të përfshirë (sipas sektorëve përkatës);
- Me qëllim shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve të përfshira nëpërmjet SIM, u miratua VKM nr.672, datë 12.11.2025 “Për Krijimin e të Dhënave Shtetërore të Sistemit të Integruar Mjedisor” dhe në këtë kuadër SIM popullohet periodikisht nga AZHT për VNM-të e miratuara dhe QKB për Lejet Mjedisore. Nëpërmjet kësaj VKM, pritët që institucionet e përfshira në proces të bëjnë shkëmbimin e të dhënave, pra popullimin e sistemit me të dhënat e tyre;
- U miratua Rregullorja për funksionimin e sistemit nga AKM, me Urdhër Nr.243, datë 27.11.2025, me Nr. 12756 Prot, datë 27.11.2025;
- Databaza u regjistrua në platformën qeveritare “e-albania”.
- AKM u pajis me vulën elektronike.

Synohet që brenda 3-mujorit të parë të vitit 2026 procesi të vijojë on-line nëpërmjet platformës qeveritare e-albania.

Bashkëpunimi me EU4Green

Në kuadër të projektit EU4Green, Agjencia Kombëtare e Mjedisit bashkë me përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor morën pjesë në një vizitë studimore dy-ditore në Vjenë, të organizuar nga Agjencia e Mjedisit e Austrisë, në periudhën 2–3 dhjetor 2025. Vizita u zhvillua në kuadër të paketave të punës WP 2–3, me fokus mbështetjen e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me rrjetet dhe programet përkatëse të BE-së, veçanërisht EIONET.




Qëllimi kryesor i vizitës ishte forcimi i kapaciteteve për krijimin, menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e flukseve të të dhënave EIONET në rajonin WB6, si dhe përmirësimi i raportimit të rregullt të të dhënave drejt Agjencisë Evropiane të Mjedisit .

Gjatë sesioneve u diskutuan në mënyrë të detajuar flukset e të dhënave WISE, duke përfshirë WISE-1, WISE-2, WISE-3, WISE-4, WISE-5 dhe WISE-6, nga monitorimi kombëtar i ujërave deri te raportimi i të dhënave në nivel evropian.

Agjenda përfshinte prezantime dhe sesione interaktive mbi:

- Kërkesat e EIONET për raportim,
- Përvojën austriake në zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujit (WFD),
- Flukset e të dhënave për cilësinë e ujit, sasinë e ujit, të dhënat hapësinore dhe raportimin tematik (WISE),
- Sfidat dhe mësimet e nxjerra për ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme të flukseve të të dhënave në vendet e WB6.



Dita e dytë u shoqërua me një vizitë në terren në Vjenë, e cila u fokusua në aspekte praktike të monitorimit mjedisor dhe në aplikim.

Biznese të çliruara nga detyrimet e lejeve mjedisore

Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit ka çliruar rreth 1040 biznese nga detyrimet që burojnë nga lejet mjedisore, si më poshtë:

- ✦ 350 raste përfshijnë veprimtari infrastrukturore, për të cilat:
 - lejet mjedisore janë marrë për punime infrastrukturore tashmë të përfunduara
 - këto veprimtari nuk kërkojnë më pajisje me leje mjedisore pas përfundimit të punimeve.
- ✦ 690 raste përfshijnë leje mjedisore të cilat:
 - nuk janë në përputhje me kuadrin ligjor aktual në fuqi
 - veprimtaria që ushtrojnë nuk është më pjesë e legjislacionit mjedisor.



Si rezultat, subjektet përkatëse janë çliruar nga:

- ✦ detyrimet financiare mjedisore
- ✦ raportimet periodike mjedisore, të lidhura me lejet mjedisore të lëshuara më parë.

Konkluzioni:

➤ Më pak kosto për biznesin

- Çlirim nga detyrimet financiare
- Çlirim nga raportimet mjedisore

➤ Më pak burokraci

- Përdorim më i mirë i burimeve publike
- Pastrimi i sistemit dhe bazës së të dhënave mjedisore nga leje formale
- Pastrimi i regjistrit të lejeve mjedisore
- Statistika më të sakta

➤ Më shumë fokus në mjedis

- Vëmendja te ndikimet reale në mjedis
- Inspektime vetëm për subjektet aktive
- Eliminim i kontrolleve formale pa objekt
- Rritje e cilësisë së inspektimit
- Fokus te ndotja reale, jo te dokumentet formale.

Aktivite në lidhje me Lejet Mjedisore, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Inspektimet

Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2025 ka evidentuar subjektet të pajisur me Leje Mjedisore dhe Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM), të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimeve si më poshtë:

- ✦ 17 Leje Mjedisore Tipi A,
- ✦ 620 Leje Mjedisore Tipi B
- ✦ 922 Vlerësime të Ndikimit në Mjedis.

Janë shqyrtuar 949 aplikime, nga të cilat janë dhënë 382 Vendime për VNM Paraprake, 48 Vendime për Ente publike dhe 4 Deklaratë Mjedisore. Gjithashtu, janë shqyrtuar 135 kërkesa për dëgjuesë me publikun nga të cilat:

- 2 kërkesa për VNM paraprake.
- 6 kërkesa për VNM të thelluar.
- 133 kërkesa për Leje Mjedisore.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer inspektime në subjekte të ndryshme në fushën e mjedisit dhe të ujërave në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.

Muaji	Inspektime të programuara		Inspektime të realizuara		Inspektime jashtë planit	
	Ujëra	Mjedis	Ujëra	Mjedis	Ujëra	Mjedis
Shtator	3	0	3	38	0	3
Tetor	0	0	0	28	0	28
Nëntor	0	0	0	19	0	19
Dhjetor	9	30	9	30	0	0
Totali	12	30	12	115	0	50

Po ashtu janë zhvilluar procedura asgjësimi për produkte të skaduar apo të dëmtuara me kërkesë të subjekteve të ndryshme.

Muaji	Procedura asgjësimi
Shtator	34
Tetor	23
Nëntor	20
Dhjetor	32
TOTALI	109